UNIVERSITETI I TETOVËS

УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

UNIVERSITY OF TETOVO

02-1810/1

27-06 2023

Në bazë të nenit 97 paragrafi (12) të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/'18 dhe 178/'21), nenit 101 paragrafi (2) pika 10 dhe 11 të Statutit të Universiteti i Tetovës, si dhe Procesverbalit përfundimtar nga rezultatet e përmbledhura për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës, për mandatin 2023-2026, Komisioni Universitar i Zgjedhjeve solli këtë

**VENDIM**

**për caktimin e kandidatit të zgjedhur për rektor të Universitetit të Tetovës**

**Neni 1**

Në bazë të rezultateve përfundimtare të përmbledhura të dorëzuara të votimit të fshehtë të njësive të Universitetit, rektor i Universitetit të Tetovës është zgjedhur prof. dr. Jusuf Zejneli, profesor ordinar në Fakultetin Juridik.

**Neni 2**

Mandati i rektorit të zgjedhur zgjat 3 (tre) vjet, gjegjësisht për periudhën 2023-2026.

**Neni 3**

Të drejtat dhe detyrimet e rektorit përcaktohen me Ligjin për arsimin e lartë, me Statutin e Universitetit të Tetovës dhe me akte të tjera të Universitetit të Tetovës.

**Neni 4**

Procesverbali përfundimtar i komisionit universitar të zgjedhjeve për rezultatet e përmbledhura për zgjedhjen e rektorit është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**Kryetari i**
**komisionit universitar të zgjedhjeve**
**prof. dr. Nderim Zeqiri**

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi)